

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6689
E premte, 26 gusht 2022
çmimi 0.40 €

Limaj bën homazhe në
Ditën e Dëshmorëve të
Brigadës 121 "Ismet Jashari
- Kumanova" | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GREVAT RIKTHEHEN, QEVERIA I KËRCËNON GREVISTËT PËR MOSDHËNIE TË PAGËS



Greva për rritje page e punëtorëve në sektorin publik e nisur të enjten ka nxitur reagimin e Qeverisë së Kosovës. Ministria e Financave ka bërë me dije se nëse edhe për një orë një zyrtar është në grevë, ai nuk do të paguhet për atë orë. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe

Lirive të Njeriut (KMDLNj) nëpërmjet një komunikate për medie thotë se kërcënimet e bëra nga përfaqësues të qeverisë për grevistët janë shkelje të të drejtave të njeriut. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja u kanë dhënë përkrahje grevistëve

OPINION

A DO TË DRIDHEN
PRISHTINA DHE BEOGRADI
NGA PORDHAT E MIUT? F. 8-9

Behxhet
Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



BRITANIA E MADHE PËR HERË TË
PARË NUK IMPORTON NAFTË DHE
GAZ NGA RUSIA F. 8

NË DY OPERACIONE POLICORE TË
NDARA NË PEJË DHE NË GJAKOVË,
ARRESTOHEN PESË TË DYSHUAR F. 8

EKONOMI

ATK-ja NJOFTON SE JANË
INKASUAR 417 163 EURO BORXHE F. 8

SHEFJA E USAID-it: KOSOVA RRIITI
NDJESHËM BAZËN TATIMORE GJATË
DEKADËS SË FUNDIT F. 8

SPORT



NORA GJAKOVA DHE DISTRIA
KRASNIQI PUNËSOHEN ME GRADËN
E KOLONELIT NË MINISTRINË E
MBROJTËS SË SHQIPËRISË F. 10



LAJÇAKU
NË
MITROVICËN
E VERIUT:
NUK MUND
TË KETË MË
BARRIKADA | FAQE 5



SPECIALJA REFUZON KËRKESËN
PËR RIKLASIFIKIMIN E MATERIALIT
DËSHMUES NË RASTIN E
DREJTUESVE TË UÇK-së | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Putini nënshkruan dekretin për ta rritur numrin e forcave ushtarake ruse

Moskë, 25 GUSHT - Presidenti rus Vladimir Putin nënshkroi të enjten një dekret për ta rritur numrin e forcave të armatosura ruse në 2 390 758 nga 1 902 000 që janë aktualisht. Sipas dekretit të nënshkruar më 25 gusht, numri i personelit ushtarak do të rritet nga 1 013 628 në 1 150 628 efektivë. Në dekret përmendet edhe personeli që do të punësohet nga radhët e civilëve për llogari të forcave të armatosura ruse.

Dekreti do të hyjë në fuqi më 1 janar 2023.

Dekreti vjen shtatë muaj pas pushtimit të paprovokuar të Ukrainës dhe mes raportimeve të pakonfirmuara për humbje të konsiderueshme të pësuar nga forcat e armatosura ruse gjatë këtij konflikti.

Më 29 maj presidenti Vladimir Putin nënshkroi një ligj që u mundëson personave mbi 40 vjeç të regjistrohen në forcat e

armatosura. Më parë ushtria ruse kishte kufij moshe për rekrutimin e ushtarëve nga 18 deri në 40 vjeç. Ekspertët ushtarakë ukrainas dhe perëndimorë thonë se Rusia ka pësuar humbje të mëdha në luftën që po zhvillohet në Ukrainë. Edhe pse lideri rus nuk i ka pranuar dhe i ka mohuar gjithmonë shifrat e publikuara sa iu përket humbjeve të ushtrisë ruse gjatë kësaj periudhe, lëvizjet e tij tregojnë të kundërtën.



Gjykata ia zgjat lirimin me kusht ish-kryeministrit pakistanez



KARAÇI, 25 GUSHT - Një gjykatë në Pakistan ia ka zgatur për një javë lirimin me kusht ish-kryeministrit pakistanez Imran Khan mbi akuzat për terrorizëm që kanë ndezur tensionet politike në vend.

Vendimi i gjykatës i marrë më 25 gusht zgjat masën deri më 1 shtator. Khani, ish-yll ndërkombëtar i briketit - i kthyer në politikan, ishte i pranishëm në seancën dëgjimore në Islamabad.

"Reuters" citoi avokatin dhe ndihmësin politik të Khanit, Babar Awan, të ketë thënë se ekipi i mbrojtjes do të vazhdojë të aplikojë për zgjatje [të masës] për aq kohë sa të jetë e nevojshme.

Akuza për terrorizëm, e ngritur më 22 gusht, pasoi një fjalim të mbajtur nga Khan në Islamabad, gjatë të cilit ai u zotua se do t'i padiste oficerët e policisë dhe një gjykatës, dhe pretendoi se ata kishin torturuar një bashkëpunëtor të ngushtë pas arrestimit të tij.

Prej kur është rrëzuar nga pushteti në muajin prill, Khan ka qenë kritik i zëshëm i qeverisë dhe ushtrisë së shtetit.

Autoritetet e kanë akuzuar Khanin se ka shkelur aktin kundër terrorizmit pasi supozohet se ka kërcënuar ish-zyrtarët shtetërorë.

Të shtunën rregullatori për medie në Pakistan ka bërë me

dije se kanaleve televizive u ndalohet transmetimi i fjalimeve të drejtpërdrejta të Khanit dhe ka akuzuar ish-liderin për gjuhë urrejtjeje ndaj institucioneve shtetërore.

Khan pretendon se qeveria po tenton ta censurojë atë.

Politikani karimazik është zgjedhur kryeministër më 2018, mirëpo është përplasur ashpër me ushtrinë në fund të mandatit.

Pas një serie dezertimesh, ai ka humbur shumicën në parlament. Ai është rrëzuar nga pushteti përmes një vote mosbesimi në muajin prill, pasi opozita e ka akuzuar për keqmeanaxhim ekonomik, në kohën e rritjes së inflacionit.

Më shumë se 180 viktima gjatë një muaji nga përmbytjet në Afganistan



KABUL, 25 GUSHT - Të paktën 182 njerëz humbën jetën dhe qindra të tjerë janë plagosur gjatë një muaji përmbytjesh nga shirat sezonale në Afganistan.

Zabihullah Muxhahid, zëdhënësi i talibanëve, tha të enjten se më shumë se 250 njerëz u plagosën si rezultat i përmbytjeve, ndërsa më shumë se 3 000 shtëpi u shkatërruan ose u dëmtuan. Muxhahid tha se të paktën 182 njerëz kishin humbur jetën si pasojë e përmbytjeve.

Numri më i madh i vdekjeve ka

ndodhur mes 16 dhe 21 gushtit, kur 63 persona humbën jetën nga përmbytjet. Tridhjetë të tjerë raportohen të zhdukur dhe më shumë se 8 200 familje janë prekur në 13 provinca, sipas Zyres së OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare.

Kohët e fundit në provincën lindore të Logarit, fshatarët në rrethin Khushi thanë se përmbytjet ishin të paprecedentë në historinë e zonës. Aty vërshimet e ujit kanë vrarë kafshët, kanë marrë përpara shtëpitë dhe përmbytur tokat

bujqësore. Njerëzit janë detyruar t'i braktisin shtëpitë e tyre për të gjetur strehim në male.

Në provincën veriore të Parwanit, përmbytjet shkatërruan dhjetëra shtëpi në tre qarqet e prekura.

Departamenti Lokal i Motit ka paralajmëruar se më shumë shira priten në ditët në vijim në shumicën e 34 provincave të Afganistanit. Shirat e dendura dhe përmbytjet në të gjithë vendin shkaktojnë vdekjen e 40 personave në korrik dhe 19 të tjerëve një muaj më parë.

Gjykata në Tajlandë pezullon kryeministrin nga detyra

Bangkok, 25 gusht - Gjykata e Lartë e Tajlandës ka pezulluar nga detyra zyrtare kryeministrin Prayuth Chan-ocha. Partitë opozitare të vendit ngritën një çështje duke deklaruar se kryeministri Prayuth e kishte tejkaluar mandatin e tij në detyrë. Kushtetuta e Tajlandës i kufizon me dy mandate kryeministrat në detyrë.

Kundërshtarët dhe aktivistët politikë që kërkuan largimin e Prayuth kishin argumentuar se mandati i tij filloi kur ai u bë udhëheqës i juntës dhe u emërua kryeministër i qeverisë së re ushtarake në gusht të vitit 2014.

Ish-shefi i ushtrisë mori pushtetin pas grushtit të shtetit të vitit 2014-t dhe më pas mbajti detyrën më 2019 pas zgjedhjeve

të kontestuar nga opozita. Sipas këtij pretendimi, mandati i tij duhet të përfundojë këtë javë. Pritet ende një vendim përfundimtar, por gjykata urdhëroi pezullimin e tij teksa çështja po shqyrtohet. Kjo vjen pasi gjatë viteve të fundit ai është përballur me rritjen e opozitës edhe pse i mbijetoi një vote mosbesimi kundër tij muajin e kaluar.



Specialja refuzon kërkesën për riklasifikimin e materialit dëshmuar në rastin e drejtuesve të UÇK-së



PRISHTINË, 25 GUSHT - Gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, ka refuzuar kërkesën e mbrojtësve për riklasifikimin e materialit dëshmuar në rastin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Në vendim të gjykatës është thënë se mbrojtja e Thaçit, Veselit dhe Krasniqit kanë parashtruar se Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS), pa dhënë arsye, i ka klasifikuar si konfidenciale të gjitha materialet dëshmuar të zbuluara deri më tani të mbrojtja, duke shkelur kështu rregullën 83(1) të Rregullores dhe në përgjithësi, të drejtën e të akuzuarit për një gjykim të drejtë dhe publik, siç parashikohet, ndër të tjera, në nenin 21(2) të Ligjit. Mbrojtja është thënë se ka kërkuar që gjyqtari i procedurës paraprake: (i) të urdhërojë ZPS-në të riklasifikojë çdo material jokonfidencial si publik; (ii) ta urdhërojë ZPS-në ta justifikojë klasifikimin konfidencial të materialeve dëshmuar që nuk janë të disponueshme publikisht; dhe (iii) të caktojë një afat kohor për përfundimin e riklasifikimit të materialit zbulues nga ZPS-ja. Në anën tjetër është thënë se ZPS-ja përgjigjet se mbrojtja e keqkupton qëllimin e parimit të publicitetit të procedurave dhe se në fazën aktuale paraprake të procedurës, në veçanti një klasifikim konfidencial mbetet i përshtatshëm për një pjesë të konsiderueshme të sendeve provuese, duke përfshirë sendet që mund të duken se janë publike.

Më tutje është thënë se, megjithatë, ZPS-ja "këshillon që do të rishikojë, dhe kur është e përshtatshme, do ta rishikojë klasifikimin e materialeve provuese përpara fillimit të gjyqimit dhe [...] [që] klasifikime të tilla do të mbeten nën shqyrtim gjatë gjithë procedurës". Në vendimin në fjalë është thënë se në fillim gjyqtari i procedurës paraprake kujton se, në përputhje me rregullin 83(1) të Rregullores, çdo procesverbal jopublik i procedurës dhe provave do t'i tregojë arsyet për një klasifikim të tillë dhe nëse dhe kur mund të riklasifikohet. "Për më tepër, gjyqtari i procedurës paraprake rikujton vendimin kuadër për zbulimin e provave dhe çështjet e ndërlidhura ('Vendimi kuadër për zbulimin'), i cili specifikon se [...] gjatë zbulimit të provave, palët do ta përcaktojnë nivelin e duhur të klasifikimit të çdo sendi dhe do t'i regjistrojnë provat si publike, përveç nëse ekzistojnë arsye për ta klasifikuar materialin ndryshe, në përputhje me rregullin 83(1) të rregullave, është thënë në këtë vendim. Sipas vendimit, për një pjesë të konsiderueshme të materialit dëshmuar të zbuluar, në veçanti materialet e lidhura me dëshmitarët (deklaratat e marra nga ZPS-ja dhe institucionet e tjera, si dhe materialet e lidhura me ato deklarata) ose materialet e marra nga institucione të tjera ndërkombëtare, gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar masat mbrojtëse pas

shqyrtimit të arsytimit të duhura të ofruara nga ZPS. Po ashtu, në vendim është thënë se një material i tillë ruan klasifikimin e tij deri në momentin kur masat mbrojtëse të urdhëruara gjyqësore do të hiqen, ose siç urdhërohet ndryshe nga një panel. Ndërsa është thënë se sa i përket materialit që është i disponueshëm publikisht, gjyqtari i procedurës paraprake konstaton se, pavarësisht nga disponueshmëria e tij publike, mund të ekzistojnë arsye për klasifikimin konfidencial të një materiali të tillë në procedurat para Dhomës së Specializuar. "Për shembull, materiali i disponueshëm publikisht mund të duhet të mbahet konfidencial, në këtë fazë: (i) për ta mbrojtur sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave që marrin pjesë në procedurë dhe personave të tjerë në rrezik për shkak të dëshmitarëve të dhëna nga dëshmitarët e Dhomave të Specializuara; ose (ii) sepse disa detaje të përfshira në të ose përfundimet që ZPS nxjerr prej tyre nuk janë (ende) në domenin publik", është thënë në këtë vendim. Sipas vendimit, për më tepër, çështja e (ri-)klasifikimit të materialeve jokonfidenciale duhet të konsiderohet më tej kundër klimës së përgjithshme të ndërhyrjes dhe frikësimit të dëshmitarëve që mbizotëron në Kosovë. Prandaj, thuhet se një material i tillë gjithashtu ruan

klasifikimin e tij, përveç nëse një panel urdhëron ndryshe. "Mbrojtja pretendon se riklasifikimi është i nevojshëm për ta bërë efektive të drejtën e të akuzuarit për publicitet. Ndërsa publiciteti i procedurës është një e drejtë themelore e të akuzuarit sipas nenit 21(2) të ligjit, gjyqtari i procedurës paraprake rikujton se kjo e drejtë nuk është absolute, por u nënshtrohet kufizimeve të nevojshme për mbrojtjen e interesave të tjera, duke përfshirë sigurinë e dëshmitarëve", është thënë në këtë vendim. Gjithashtu, është thënë se për më tepër, provat nuk diskutohen në fazën paraprake, por në gjykim dhe, se si rezultat, materiali provues mund të mbetet konfidencial në fazën paraprake, siç përshkruhet më sipër. Vendimi është thënë se, nga ana tjetër, procedurat paraprake janë në një fazë të avancuar, është urdhëruar dorëzimi i procesverbaleve të mbrojtjes, për disa dëshmitarë ka përfunduar periudha e vonuar e zbulimit dhe identiteti i tyre i është bërë me dije mbrojtjes. Sipas vendimit, hetimet e mbrojtjes janë duke u zhvilluar për disa muaj, ekziston një kornizë për trajtimin e informacioneve konfidenciale dhe transmetimi i dosjes së lëndës në një trup gjykues do të ndodhë në të ardhmen e afërt. Po ashtu, është urdhëruar ZPS-ja që kur i zbulon mbrojtjes materialet të tjera jokonfidenciale, ta përcaktojë nivelin e duhur të klasifikimit, t'i tregojë arsyet për çdo klasifikim jopublik dhe të tregojë nëse dhe kur

ky material jokonfidencial mund të riklasifikohet, në përputhje me rregullën 83(1) të rregullave. Ndryshe, më 29 prill, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit. Prokuroria është duke pretenduar se katër të akuzuarit kanë kryer krime lufte edhe në Gjilan, Budakovë e Semetishtë. Në aneksin e publikuar sa iu përket krimeve që pretendohen se ndodhën në Semetishtë dhe Budakovë, prokuroria ka listuar krimet e luftës si arrestimi dhe ndalimi i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor ose çnjerëzor, torturë, vrasje. Ndërkaq, si krime kundër njerëzimit i ka listuar burgimin, vepra të tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen, zhdukjen e personave me forcë dhe persekutimin. Kurse për krimet që pretendon që ndodhën në Gjilan, si krime lufte i ka listuar arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor ose çnjerëzor, torturën dhe vrasjen. Ndërsa si krime kundër njerëzimit ka listuar burgimin, vepra të tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen dhe persekutimin. Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë ka deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Selimi më 11 nëntor. Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020.

GREVVË NUK PUNOHET

Grevat rikthehen, qeveria i kërcënon grevistët për mosdhënie të pagës

Greva për rritje page e punëtorëve në sektorin publik e nisur të enjten ka nxitur reagimin e Qeverisë së Kosovës. Ministria e Financave ka bërë me dije se nëse edhe për një orë një zyrtar është në grevë, ai nuk do të paguhet për atë orë. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) nëpërmjet një komunikate për medie thotë se kërcënimet e bëra nga përfaqësues të qeverisë për grevistët janë shkelje të të drejtave të njeriut. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja u kanë dhënë përkrahje grevistëve

bashkuar kësaj greve duhet të pezullohen nga paga. Sekretari i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Enis Spahiu, i tha "Radios Evropa e Lirë" se nëse edhe për një orë një zyrtar është në grevë, ai nuk do të paguhet për atë orë. Spahiu theksoi se grevistëve ua kanë garantuar të drejtën e grevës por, siç ka thënë ai, i kanë njoftuar që duhen zbatuar edhe dispozita ligjore që, sipas tij, kërkojnë pezullimin e obligimeve të kontratës së punës.

Në Ligjin për Greva të Kosovës thuhet se "organizatat sindikale, apo gjysma e të punësuarve të një organizatë të caktuar punuese, ku nuk ka organizim sindikal, kanë të drejtë të organizojnë greva për t'i mbrojtur interesat e tyre ekonomike, sociale dhe profesionale".

Neni 18 i Ligjit për Greva thotë se gjatë zhvillimit të grevës pezullohen detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, duke përfshirë të drejtën në pagesë dhe detyrimin e bindjes për të punuar. Por, sipas Ligjit për Greva, ndërprerja ose largimi nga

marrëdhënia e punës për shkak të pjesëmarrjes në një grevë të ligjshme është i kundërligjshëm. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës përmes një komunikate për medie ka theksuar se tashmë janë në grevë të përgjithshme dhe kjo ka ardhur pa dëshirën e tyre, por janë detyruar nga premtimet dhe zvarritjet për përmbushjen e kërkesave të ligjshme dhe të arsyeshme. "Nga premtimet që nuk u përmbushën kurrë dhe nga zvarritjet e qëllimshme që prodhuan këtë - hyrjen në grevë. Partnerja jonë sociale - qeveria - po i kërcënon grevistët. Kjo është antiligjore, se shkelet Ligji për Greva, Ligji nr. 03/L-200, nenet 11, 13 dhe 18, mbi të gjitha kjo nuk është aspak e mirë. T'i kërcënoh grevistët e qetë dhe në të drejtën e tyre është shkelje e normës dhe parimeve të shtetit demokratik e juridik dhe, mbi të gjitha, marrje e së drejtës për grevë. Me fjalë të tjera, është gabim shumë i madh. Partnerja jonë sociale - qeveria - duhet t'i jepet arsyes dhe të ulet në tavolinën e dialogut të sinqertë prej nga duhet të dalim me

zgjidhjen e duhur. Zgjidhja e duhur është përmbushja e kërkesave të të punësuarve", është thënë në reagimin e BSPK-së.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) nëpërmjet një komunikate për medie thotë se kërcënimet e bëra nga përfaqësues të qeverisë për grevistët janë shkelje e të drejtave të njeriut. "Organizimi dhe veprimi sindikalist është i rregulluar dhe lejohet me ligj. KMDLNj-ja i bën thirrje Qeverisë së Kosovës t'i ulë armët e kërcënimit dhe të gjejë një zgjidhje bashkë me sindikatat", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Për 100 euro shtesë deri në miratimin e legjislacionit për pagat, por edhe për kërkesa të tjera, sindikalistët kanë protestuar më 8 prill të këtij viti. Në muajin maj disa institucione publike, siç janë ato të arsimit, administrata publike, energjetika, dogana, kanë mbajtur grevë njëorëshe.

Qeveria e Kosovës, disa ditë më vonë, në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike, ka vendosur të ndajë nga 100 euro shtesë për muajin prill për disa kategori të

**EPOKA
ERE** Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 GUSHT - Mësimdhënësit, edukatorët në kopshtet publike, punëtorët e administratës publike, shërbyesit civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës nga dita e enjte kanë hyrë në grevë. Por, nga qeveria thonë se nuk është koha për greva, pasi është hartuar Projektligji për Paga.

Kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve, drejtuar Qeverisë së Kosovës, është ndarja e 100 eurove për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Projektligji për Paga.

Këshilli grevist i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës gjatë ditës së enjte ka bërë disa vizita te punëtorët të cilët tashmë kanë nisur grevën. Fillimisht Këshilli ka vizituar edukatorët në një kopsht publik në Prishtinë, si dhe punëtorët në komunën e Prishtinës. Këshilli grevist ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta fillojë realizimin e kërkesave të tyre.

Mediet e kanë siguruar një dokument i cili u ka shkuar grevistëve nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Enis Spahiu, në të cilin thuhet se të gjithë ata që i janë

Lajçaku në Mitrovicën e Veriut: Nuk mund të ketë më barrikada

PRISHTINË, 25 GUSHT - Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë se në veri të Kosovës nuk mund të përsëriten tensionet e 31 korrikut, kur disa serbë lokalë ngritën barrikada për ta penguar Qeverinë e Kosovës për zbatimin e vendimeve të saj për targa dhe dokumente udhëtimi.

Lajçak, bashkë me të dërguarin e ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe ambasadorin amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, takuan mëngjesin e së enjtes përfaqësuesit serbë në veri të Kosovës. "Kjo është arsyeja përse jemi sot këtu, që njerëzit të mos

kenë frikë, të mos kenë frikë për jetën e tyre, për një jetë normale... Ne po bëjmë gjithçka për t'u siguruar që të mos ketë barrikada", ka thënë Lajçaku pas takimit të zhvilluar në Mitrovicën e Veriut.

Ai nuk dëshiroi të flasë për zgjidhje dhe propozime të mundshme, duke thënë se "misioni po vazhdon" dhe se paqja duhet të ruhet.

Lajçak, po ashtu, nuk iu përgjigj pyetjes së gazetarëve nëse bashkësia ndërkombëtare kërkon nga Kosova që ta shtyjë edhe një herë zbatimin e vendimit - për tre muaj të tjerë, siç u spekulua në disa medie në Kosovë. "Ka aq shumë spekulime rreth këtij

procesi. Nuk dua të futem në to", ka thënë ai.

Diplomati evropian nuk komentoi as deklaratën e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, se nga 1 shtatori do të nisë zbatimin e vendimeve për targa dhe dokumente udhëtimi, por tha se "po punohet që të mos ketë barrikada". "Unë jam optimist dhe duhet të jem optimist. Ne duam që 1 shtatori të jetë një ditë normale dhe e zakonshme", ka thënë Lajçak.

Escobar i tha se "misioni vazhdon në Beograd" dhe se ai shpreson të bëjë një deklaratë në Beograd sot ose nesër.

As Lista Serbe, subjekti më i madh serb në Kosovë, përfaqësues të të

cilit morën pjesë në takim, nuk u prononcua për medie.

Escobar dhe Lajçaku e nisën vizitën në Kosovë më 23 gusht. Ata takuan fillimisht presidentin e Kosovës, Vjosa Osmani, më pas kryeministrin Albin Kurti dhe përfaqësues të opozitës.

Qëllim i vizitës së tyre u tha të jetë evitimi i përsëritjes së tensioneve në veri të Kosovës.

Disa serbë atje u rebeluan më 31 korrik, pasi Qeveria e Kosovës mori vendim për reregjistrimin e makinave të tyre - nga targat që i lëshon Serbia me targa të Kosovës - si dhe për lëshimin e dokumenteve të Kosovës për të gjithë serbët që hyjnë në Kosovë.

Pas tensionimit të situatës dhe

sugjerimit të bashkësisë ndërkombëtare, Qeveria e Kosovës e shtyu zbatimin e vendimeve të saj për 1 shtator.

Escobar i tha të mërkurën pas takimit me udhëheqësit institucionalë dhe të partive opozitare në Prishtinë se pret që Kosova dhe Serbia të kenë një propozim konkret për zgjidhjen e çështjes së targave dhe të dokumenteve serbe. Ai ka thënë se është siguruar se askush nuk dëshiron përshkallëzim të situatës apo dhunë më 1 shtator.

Escobar dhe Lajçaku kanë udhëtuar të enjten për në Beograd, ku do të takohen me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.



shoqërisë, përfshirë punëtorët në sektorin publik dhe privat. Por, këto mjete, sipas sindikatave të punëtorëve, kanë qenë të pamjaftueshme për ta zburuar gjendjen e rënduar ekonomike të punëtorëve nga rritja e çmimeve të konsumit.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave, Kosova po përballlet me një inflacion të lartë. "Jo më shumë, 100 euro modeste, që të përballemi më lehtë me çmimet që po rriten çdo ditë", thotë Rrahman Jasharaj nga këshilli grevist i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK).

Sipas Jasharajt, përfaqësuesit e këshillit grevist të secilës sindikatë do të vendosin për mënyrën e organizimit të grevës.

Në arsim, aty ku Jasharaj është kryetar i sindikatës, thotë se të gjithë të punësuarit - mësuesit dhe edukatorët e kopshteve - do të dalin në punë nga ora 09:00 deri në 12:00, por nuk do të punojnë. "Mësim nuk do të ketë derisa nuk mbyllet greva. Greva mbyllet vetëm atëherë kur realizohen kërkesat", thotë Jasharaj. Ai shton se grevën e kanë përkrahur edhe policët e zjarrfikësit, por në bazë të Ligjit

PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja i përkrahin grevistët

PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja kanë reaguar pas lajmit se Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Financave, do t'ua ndërprejë pagat punëtorëve që i janë bashkuar grevës të nisur sot nga Bashkimi i Sindikatave të Bashkuara të Kosovës (BSPK).

Deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, në "Facebook" ka thënë se kur jemi te grevat, Vetëvendosja sa ishte në opozitë i mbështeste ato. "Sot në pushtet vendimet e kësaj qeverie ndaj grevistëve janë skandalozë dhe nuk i ngajjnë aspak një shteti demokratik. Vetëm ish-sistemet kanë penguar kërkesat e punëtorëve për mirëqenie më të lartë, pagë

optimale e siguri në punë. Greva është e drejtë e garantuar me ligj", ka shkruar Deliu-Kodra.

Në anën tjetër, deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se partia në pushtet, qeveria dhe Kurti duhet të gjejnë zgjidhje e jo të konfrontohen me grevistët. Në "Facebook" ajo ka shkruar se Lëvizja Vetëvendosje dikur, përkrahëse e secilës grevë në sektor publik e privat, duhet të gjejë zgjidhje të shpejtë për grevën e nisur sot sepse dëmi nga zgjatja e grevës mund të jetë e parikuperueshme. "Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, e ka për obligim të ulet me sindikalistët, ta nisë dialogun

social dhe të gjendet një zgjidhje për përfundimin e grevës. Vetëvendosja ka ardhur në pushtet duke premtuar zgjidhje për secilin problem në nivel lokal, në nivel qendror, në nivel mbarëkombëtar e ndërkombëtar", ka thënë Bajrami. Sipas saj, në vend të zgjidhjeve, qeveria ka zgjedhur konfrontimin me sindikatat si rrugë e vetme, e cila, sipas deputetes Bajrami, është rrugë e gabuar pasi që pasojat do t'i bartin të gjithë e jo veç partia në pushtet e kryeministri Kurti.

Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kurti ka një vit e gjysmë që tallet me punëtorët.

"Kryeministër, mos e kërko fajin te punëtorët, por te vetja jote. Ka më shumë se një vit e gjysmë që ti tallet me ta, për të mos thënë se po i vjedh ata. Punëtorët janë në të drejtën e tyre dhe grevat janë mjeti i vetëm që u ka mbetur në dorë, sepse kriza ekonomike e sociale u ka mbërritur në asht. Ju kryejeni punën tuaj. Miratojeni me urgjencë Ligjin e Pagave dhe reflektoni ndryshimet që kanë ndodhur. Ligji duhet të reflektojë rritjen enorme të çmimeve dhe inflacionin, që zyrtarisht ka mbërritur në 19.2%. Çdo formulë tjetër do t'ju kthehet në bumerang. Është sosur durimi", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

për Grevë ata nuk kanë të drejtë ta organizojnë atë.

Por, sipas kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, pas procedimit të Projektligjit për Paga, "grevë e sindikatave ka humbur kuptimin". Në një konferencë për medie në Prishtinë më 24 gusht, Kurti tha se është informuar me kërkesat e

punëtorëve. "Kërcënimi me paralizim të institucioneve dhe shërbimeve publike tash që Projektligji për Paga është proceduar dhe kushtëzimi me kërkesa shtesë është gabim. Nuk është koha për grevë. Është koha për punë. Është koha që sindikatat t'i bëjnë komentet e

tyre për Projektligjin për Paga", tha Kurti.

Përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë thonë se dialogu social midis qeverisë dhe sindikatave është i nevojshëm që të shmangët paralizimi i institucioneve. Gersi Gashi, drejtor i hulumtimeve dhe zhvillimeve në Qendrën për

Politika dhe Avokim në Prishtinë, thotë se paralajmërimi për grevë i shumë sindikatave të punëtorëve është shqetësues, pasi mund të paralizohet një pjesë e madhe e shërbimeve. Ai thotë se ekzekutivi dhe sindikatat duhet të bisedojnë për të gjetur zgjidhje për këtë situatë.

Në dy operacione policore të ndara në Pejë dhe në Gjakovë, arrestohen pesë të dyshuar

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 25 gusht - Policia e Kosovës, hetuesit policorë nga Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit, më 25 gusht kanë zhvilluar operacione policore në rajonin e Pejës dhe në rajonin e Gjakovës. Operacioni policor i zhvilluar në rajonin e Pejës ka ardhur si rezultat i zhvillimit të hetimeve intensive me qëllim të zbardhjes së veprimtarive kriminale ku të përfshirë kanë qenë disa persona të dyshuar për trafikim të armëve. Gjatë operacionit policor janë identifikuar dhe arrestuar katër të dyshuar meshkuj kosovarë. "Gjatë zhvillimit të këtij operacioni janë kryer kontrole të shtëpive dhe objekteve përcjellëse, prona të të dyshuarve, me qëllim të mbledhjes së provave dhe dëshmive ku janë gjetur dhe

konfiskuar: Pesë armë (një AK-47 dhe katër revole), një predhë trombloni, dyqind fishekë të kalibrave të ndryshëm dhe dëshmi të tjera", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Operacionit policor të zhvilluar në rajonin e Gjakovës i kanë paraprirë procedurat e aplikimit të masave të fshehta të hetimit në kuadër të parandalimit dhe luftimit të dukurisë së kultivimit të bimëve narkotike. "Si rezultat i zhvillimit të këtij plani operativ është identifikuar një person i dyshuar mashkull/kosovar, i cili është arrestuar pasi i njëjti në një zonë malore të lokacionit të lartpërmendur kishte kultivuar bimë narkotike të llojit 'kanabis sativa', ku janë gjetur gjithsej njëqind e shtatë bimë të llojit të lartcekur me një gjatësi prej 2.5 m të cilat me udhëzim të prokurorit kompetent janë shkatërruar, ndërsa një pjesë e tyre janë



marrë për ekzaminim", ka njoftuar Policia e Kosovës. Si rezultat i këtij operacioni policor, në shtëpinë dhe objektet përcjellëse, pronë e tij, është kryer kontroll, ku janë

gjetur dhe konfiskuar: Një armë automatike AK-47 me karikator dhe shtatëmbëdhjetë fishekë, një karikator i revoles me njëmbëdhjetë fishekë. "Në lidhje me rastet e cekura për të

gjitha veprimet e marra është njoftuar prokurori kompetent me aktvendim të të cilit ndaj të dyshuarve është caktuar masa e ndalimit për 48 orë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Kërkohet kthimi i mbi 160 punëtorëve në vendin e punës



PRISHTINË, 25 GUSHT - Për të pestën herë me radhë kanë protestuar punëtorët e kompanisë "Kosova Thëngjilli". Me dhjetëra punëtorë të kësaj kompanie kanë qëndruar të enjten për më shumë se katër orë para objektit të Ministrisë së Ekonomisë. Ata kanë kërkuar rikthimin në punë pas ndërprerjes së punës nga Korporata Energjetike të Kosovës (KEK).

Punëtorët dy herë kanë hyrë brenda me ftesë për takim, por në asnjërin rast nuk janë pritur në takim nga ministria, Artane Rizvanolli.

Kryetari i aksionarëve i kompanisë "Kosova Thëngjilli", Imri Restelica, i cili është pritur në takim nga këshilltari Vullnet Gacaferri, ka thënë se nuk shpresojnë në zgjidhje të problemit të tyre. "Kërkova për mundësinë e vazhdimit të punës. Në bazë të bisedimeve, ai do t'ia përcjellë ministres të

gjitha këto probleme që i kemi ne. Mirëpo, absolutisht po shihet që ky problem është shumë i madh jo vetëm i ministrisë, por edhe më i madh. Përmes kompanisë KEK dhe 'Kosova Thëngjilli', sipas tyre, 'nuk mund të ndërhyjmë shumë, sepse duhet të konsultohemi me zyrën ligjore dhe të bisedojmë për më tutje', ka njoftuar ai para protestuesve. Sipas tij, mbi 160 punëtorë padrejtësisht kanë mbetur pa punë. Megjithatë, Restelica tha se nuk ka marrë ndonjë përgjigje konkrete. "Derisa të kemi një takim tjetër zyrtar nuk mund të them që kemi një pozitivitet dhe fjalë pozitive që mund të kryhet diçka. Nuk kanë dhënë afat dhe kohë të caktuar", ka shtuar ai.

Protestuesit janë shprehur të indinjuar me qasjen e zyrtarëve të Ministrisë së Ekonomisë, për çka kanë kërkuar takim me vetë ministren Artane Rizvanolli.

Limaj bën homazhe në Ditën e Dëshmorëve të Brigadës 121 "Ismet Jashari - Kumanova"

MALISHEVË, 25 GUSHT - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i shoqëruar nga kryetari i komunës, Ekrem Kastrati, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, si dhe bashkëpunëtorë, ka bërë sot homazhe në Kleçkë, me rastin e Ditës së Dëshmorëve të Brigadës 121 "Ismet Jashari - Kumanova". "Kjo datë me vlerë është vendtakim i të gjallëve me

shokët që kanë rënë dhe familjarët e tyre për ta kujtuar veprën e tyre, krenarinë e sakrificën që kanë bërë ushtarët e kësaj brigade", ka thënë Limaj. Po ashtu, ai ka thënë se këto shenja të lirisë, ky përkujtim, na përkujton se sa shumë sakrificë është bërë për lirinë të cilën e gëzojmë sot.

Kryetari Limaj, po ashtu, ka thënë se 25 gushti është përmbledhje e gjithë asaj trimërie, sakrifice, lavdie e

dhimbje që kanë përjetuar malet e Berishës nën këtë brigadë gjatë luftës së UÇK-së. "Në këtë ditë komandant Kumanova ka dhënë jetën për lirinë e Kosovës dhe kjo është datë e shënuar për të gjithë dëshmorët e Brigadës 121, pavarësisht datës se kur kanë rënë bashkëluftëtarët e tjerë. Lavdi dëshmorëve të Brigadës 121 'Ismet Jashari - Kumanova' dhe gjithë dëshmorëve të kombit", ka thënë në Limaj fund të deklaratës.



trajtim psikiatrik. Unë nuk kam asnjë mëdyshje në këtë drejtim.

Trajtimi i rastit të mëparshëm ishte çështje e raportit Prishtinë - Beograd, kurse rasti i dytë që do të trajtohet është edhe më i rëndë se ai i pari për faktin se trajton raportet Prishtinë - Tiranë. Bëhet fjalë për refuzimin që ta takojë presidentin e Shqipërisë, Bajram Begajn, presidenti i LDK-së dhe Princi i Malçidezekut, Lartmadhëria e Tij, Mumnir Kapcixhiku. Të gjithë e takuan presidentin e Shqipërisë (opozita) në Kuvendin e Kosovës, kurse Kapcixhiku kërkoi që të vizitohet në selinë e Partisë që e drejton, në selinë e Riinvestit. Në të kundërtën, mund ta thyejë qafën përmes Qafës së Morinës e të shkoi nga ka ardhur. LDK-ja e arsyetoi këtë veprim të playboit që, në rrethana të fatkeqësive elementare politike, u bë kryetar i kësaj partie, kurse disa analistë nga Tirana dhe Prishtina që, nëse i quan idiotë e marrin si ngritje të gradës shkencore, refuzimin e Lumit të Xhikës që ta presë presidentin shqiptar e përkrahin shkak se, gjithnjë sipas tyre, presidenti Begaj qenka pion i Edvin Kristaq Ramës, "vëlla" i Aleksandër Vuçiqit dhe se udhëheq politikë kundërshtojtë. Çfarë perversiteti idiotesk! Çfarë çrregullimi mendor! Sepse, për ta fituar mëshirën dhe bekimin e pushtetit aktual, mjafton ta sulmoni Edi Ramën se është tradhtar e që automatikisht i rritë kredencialet patriotike të kryeministrit të Kosovës. Nuk sulmohet Rama se qenka tradhtar, askush, me dy koç.. mend nuk e beson këtë, por se e konsiderojnë si kundërshtar - armik të Albin Kurtit! Çfarë perversiteti idiotesk! Po, sipas informatave, edhe presidenti Begaj ka rënë në depresion të thellë dhe po trajtohet nga psikanalistë më në zë të Shqipërisë shkak se Mumnir Kapcixhiku nuk paska pranuar ta presë në Kuvendin e Kosovës. Sigurisht po pret të formohet Zajbnica ku edhe do të realizohet kjo pritje! Nostalgjikët e Jugosllavisë alfabetin e të shkruarit dhe të menduarit e kanë me shkronja serbe, cirilike. E tillë ishte ftesa e Millos për një takim në një lokal nate të cilën Mumniri e tumiri menjëherë!

Bisedimet në Bruksel dhe pordhat nukleare: I tërë kombi kosovar u mbajt në shtetrrëhim gjatë takimit të dy "gladiatorëve në luftë me dema të tredhur", Albin

Kurtit, kryeministër 51 % i Kosovës dhe Aleksandër Vuçiq, president 60 % i Serbisë. Kjo ishte fuqia e votave të tyre. Shkas ishte 1 shtatori kur përfundon besa e Eskobarit dhënë Serbisë. Bëheshin parashikime të rënda që ndjellnin kob prandaj, thuaja dhunshëm u sollën në Bruksel, kryeministri Kurti për takim me anëtarët tjerë të delegacionit të Serbisë në krye të cilit ishte Vuçiq, Mirosllav Lajçak dhe Josef Borrell. Mediat raportonin nga takimi për një disponim mortar ku, Vuçiqi, vajtues dhe "luftëtar për paqe", në një rënë anë bënte edhe të pamundurën që të arrihet kompromisi kurse Kurti, në anën tjetër refuzonte çdo propozim, pavarësisht se nga vinte! Kjo mjaftoi që të ndizet idolatria e besnikëve të kryeministrit të cilët, edhe kësaj radhe shfrytëzuan rastin të sulmojnë heronjtë e vërtetë të luftës dhe të lirisë së Kosovës që po mbahen peng në Hagë nga një Gjykatë puro raciste. Çfarë kompromisi po ofron Vuçiqi, ky mashtrues që me lotët e një plake të përnuajtur e luan rolin e viktimës duke dribluar, së paku deri më tani të gjithë lehtësuesit e dialogut dhe qendrat e vendosjes. Vuçiqi nuk po bënë kurrfarë kompromisi, po bisedon për arat e Kosovës, për njerëzit e Kosovës, për politikën e Kosovës, për sigurinë e Kosovës dhe për statusin e Kosovës, sikur të ishte kryetar i Kosovës e jo i një shteti, Serbisë që skajshmërisht sillet armiqësisht ndaj vendit tonë! Nëse dikush do të detyrohet të bëjë kompromis ai do të jetë kryeministri Kurti e jo Vuçiq sikur që ishin politikanët kosovarë para Kurtit që u detyruan të bëjnë kompromis. Kurti i ka ra hise të bëjë kompromis, jo dosido por kompromis të dhimshëm! A do ta bëjë? Mendoj se do ta bëjë prandaj janë angazhuar shtetet miqësore dhe "miqësore" duke shtuar presion. Fillimisht e shtynë deri më 1 shtator zbatimin e reciprocitetit për targa dhe dokumente e, që, ndërkohë do të arrihet një marrëveshje e imponuar, jo për Serbinë por për Kosovën. A do të bisedonin SHBA dhe Meksiko për targa të automjeteve? Kurrë dhe asnjëherë. A do të bisedonin Franca dhe Gjermania për targa Kurrë dhe asnjëherë. Kjo është çështje ekskluzivisht e shteteve sovraane dhe të pavarura. Realisht, për të mbuluar kompromisin që për Serbinë nuk është fare kompromis, u

krijua një atmosferë lufte e cila vetëm sa nuk ka shpërthyer! Pati lëvizje të KFOR-it në veri të Kosovës. Për të na vënë në gjumë dhe për të na ushqyer egon e llaskucërisë dhe të dorëzimit përkatësisht për të na ambalazhuar frikën me një cipë të hollë trimërie, theksuan se në veri të Kosovës po shkojnë ushtarët amerikanë. Në të njëjtën kohë ambasadori Hill po thotë se në Evropë ka asociacione që mund të merren si model edhe për Kosovën duke menduar, besoj në rastin e Tirolit Jugor (Alto Adixhe), Belgjikës Lindore, kantoneve zvicerane apo, për shkak të afërsisë gjeografike edhe kantonet e Bosnjës dhe Hercegovinës që, sigurisht do të pranohej nga serbët dhe, pa asnjë dyshim edhe nga "lehtësuesit" Borrell dhe Lajçak, mbase edhe nga ambasadori Hill, me disa përmirësime kozmetike. Do të krijohet një ekuilibrim i kantonizimi serb sipas dëshirës së Vuçiqit; kantoni i Republika Serbska me Dodikun në krye dhe Zajebnica, me Goran Rakiqin, në krye. U shtuan bisedat telefonike dhe selamet e dërguara nga sekretari Bllinken, Stoltenberg, kancelari Sholc, Makroni i Frances dhe të tjerët. Nga ana e partisë në pushtet po thuhet se kjo po bëhet për shkak të vendosmërisë së kryeministrit Kurti për të mos lëshuar pe në bisedime me Serbinë. Dhashtë Zoti e të jetë ashtu! Edhe unë do t'i përkrahja, pa asnjë dyshim! Besoj se është e kundërta, lëshimet janë bërë, premtimet janë dhënë dhe duhet të përgatitet opinionin. Për ta lehtësuar këtë, tash Eskobar dhe Lajçak po shtrojnë drekë pune (nënshtrimi apo pajtimi) me krerët e opozitës të cilët si Red Bull-i, duhet ta bëjnë me krahë kryeministrin Kurti. Të gjithë po futen në një vorbull apo kazon, pozitë dhe opozitë për të relativizuar dhe shpërndarë përgjegjësinë eventuale. Këto janë presione konkrete e që do të japin rezultate konkrete. Kërcënimet për eskalim të situatës, si nga Kurti, ashtu edhe nga Vuçiqi përmes Goran Rakiqit dhe Brigadës së veriut janë pordhë të ftohta që e ngrohin atmosferën në kohë të mungesës së rrymës. As nuk do të ketë luftë e as viktimë, as bllokim të institucioneve si pasojë e largimit të serbëve nga institucionet. Ata që e bënë luftën dhe që përsëri do ta bënin janë ose në Hagë, ose në pritje për Hagë. Këta që i kanë rënë Santorinit,

Mykonos, hoteleve të shtrenjta në SHBA dhe shtetet evropiane, që në vend të kifleve po hanë kavijar dhe fruta deti, që, përveç bakllavasë i kanë rënë edhe të gjitha ëmbëlsirave tjera, nuk do të luftojnë asnjëherë. Mos do të luftojnë ata që nuk e dinë se kur është ditëlindja e Adem Jasharit por llaskucërisht e festojnë ditëlindjen e Bill Klintonit apo ata që thonë se në qiell janë bombahedhësit amerikanë kurse në tokë Baba (Skënderbeu)! Pordhë të ftohta janë këto. Sipas informatave, deri më tani kam besuar se Kosova i ka tre personalitete që thirreshin Baba. Ata janë; Albin Kurti, Enver Hasani dhe Ismet Munishi. Kah doli edhe Baba i katërt; Skënderbeu! Tradicionalisht, ku ka shumë baballarë, fëmijët (shteti) nuk është në rregull! Tash, darka apo dreka e emisarëve amerikanë dhe evropianë është një përkrahje për Albin Kurtin, një detyrim i opozitës ndaj procesit që, edhe nëse nuk dëshiron të jetë aktive, atëherë të jetë bashkëpunuese. Detyrimisht bashkëpunuese. Se çfarë opozite kanë bërë deri më tani, në planin e brendshëm, as edhe një hamburger nuk e kanë me do të pranojë, ose do rituar. Në fund të fundit, nëse botërisht deklaroheni se pa amerikanët dhe pa Brukselin nuk mund të ketë zgjidhje atëherë, si të kundërshtojmë një propozim edhe në rast se nuk na pëlqen. Albin Kurti nuk është në pozitë të mbrojtje parime, nuk ka aspak hapësirë manovruese dhe, ose do të shkojë. Procesi e mbanë në pushtet dhe procesi e largon nga pushteti, kurrsesi opozita. Dhe, mund edhe të gaboj, por, Albin Kurti me asnjë kusht nuk do të largohet nga pushteti sepse e ka ndërtuar një piramidë që është e varur ekzistencialisht nga pushteti. Përfundimisht, Zajebnica nuk është zgjidhje për Kosovën por vetëm sa e ngatërron problemin. Do të mbetet një urë lidhëse midis Kosovës dhe Serbisë, do ta ruaj dhe do ta forcojë ndikimin e Serbisë në Kosovë. Në gjendjen në të cilën jemi, Kosova ka nevojë për një zgjidhje radikale që përfundimisht e ndanë nga Serbia dhe ia pamundëson Serbisë të ndërhyjë në punët e brendshme. Këto vizita që po i bëhen Kosovës, drekat dhe darkat janë presion mbi Kosovën dhe imponim të një zgjidhjeje e cila nuk është zgjidhje. Albin Kurti e ka më së vështiri kurse Besnik Bislimi do të jetë figura

tragjike e këtij procesi kur do të hapen dhe mbyllen llogaritë.

Zhvillimet shqiptare dhe kushtimisht shqiptare:

Dritan Abazoviçi iku përlesh. Erdhi në pushtet me mashtrime dhe improvizime me qëllim të vetëm ta burgosë Babanë e shtetësisë së Malit të Zi, Milo Gjukanoviç. U lidhë me popat e Beogradit duke bërë përpjekje që Malin e Zi ta vënë nën tapi të Kishës Ortodokse të Serbisë. Milo Gjukanoviç e bëri kryeministër të Malit të Zi dhe po ky Milo ia tregoi derën. Kur u bë kryeministër i Malit të Zi asnjëherë nuk e përmendi se është shqiptar, kur e shkarkuan tha se po e bëjnë shkak se qenka shqiptar, jo se ka nënshkruar pronësinë e Malit të Zi kishës Ortodokse serbe. Dyfytirësh dhe manipulant. Nuk merittoi fund më të mirë!

Zijadin Sela dha dorëheqje nga kryetari i Alternativës Shqiptare. Ai nuk e luftoi shovinizmin maqedonas por e luftonte Ali Ahmetin. Ai asnjëherë nuk u bë lider i vërtetë sepse u shndërrua në tullumbace të Vetëvendosjes. Nuk kishte lidhësi për faktin se rolin e liderit përpiqej ta ndërtonte përmes viktimizimit pasi e rrahën në Kuvendin e Maqedonisë e jo në bazë të rezultateve që duhej t'i kishte por nuk i pati. Mbeti pa asnjë asamblist në Tetovë, kryeqytetin e shqiptarëve në Maqedoni të Veriut. Zijadin Sela nuk ka përmbajtje për t'u bërë lider i vërtetë. Dhe, fundi nuk është i keq për te, ka mundur të jetë edhe më i keq. Kjo dëshmon se përçarja dhe grindavecaria nuk sigurojnë vota e as elektorat afatgjatë dhe stabil. Mësim për disa liderë edhe në Kosovë, të fortë në paraqitje, qyqarë në përmbajtje!

Një lajm i mirë: Gëntrit Shala, djali i vetëm i heroit të kombit, humanistit, aktivistit për të drejtat e njeriut, ish-të burgosurit politik, mjekut të popullit dhe mjekut të UÇK-së, vëllait të pesë motrave, Hafir Shala u martua e që gëzoi shumë Nënë e vet Sakrifikuese, pesë motrat, familjen, miqtë dhe shokët e DOKTORIT, tash i zhdukur nga shteti i Serbisë, u martua me znj. Fjolla. Rast i veçantë dhe i gëzimit për shokë të idealit, shokë të burgut dhe shokë të luftës të DOKTORIT Hafir Shala, Elmiu, dr. Hakiu, Nuhii, Avdullahu, Idrizi dhe Behxheti që ishin të nderuar që ishin në dasmë, të respektuar nga familja e DOKTORIT dhe nga Gëntriti. Po ringritet edhe një trashëgimi kombëtare e një Patrioti të Madh si ishte Dr. Hafir Shala.

A do të dridhen Prishtina dhe Beogradi nga pordhët e miut?



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Bislim Muçiverca dhe Sigmund Frojdi: Kosova, që nga përfundimi i luftës, asnjëherë nuk ka pasur qeveri më kompetente, jo për qeverisje, por në fushën e psikoanalizës. Kur t'i dëgjoni arsyetimet, jo për dështimet, sepse dështuan ata që qeverisën 20 vjet, kurse këta të ditëve dhe netëve tona (nuk po dihet kur është ditë e kur është natë sepse po bëhet terr në pikë të ditës), kanë vetëm suksese, më së shumti në tredhje të mizave! Kur i dëgjoni se si mburren me suksese, atëherë fitohet përshtypja se ne që nuk po besojmë në këto suksese, duhet t'i nënshtrohemi, kolektivisht, një trajtimi psikiatrik e për raste më të lehta, një trajtimi psikologjik që të bindemi se nuk ka ministër më të mirë të Shëndetësisë se kaubojsi i Llapushnikut, se nuk ka ministër më të mirë të mbrojtjes se vikingu me prejardhje shqiptare nga fjordet e Norvegjisë, se nuk

ka ministre më të kualifikuar për terrin në pikë të ditës se xhoistikja e Binit, se nuk ka ministre më të zonjën për moszhvillim dhe rritje të varfërisë se Helena e Greqisë e cila në baza vullnetare bëri hulumtim me rezultate, deri më tani të panjohura shkencërisht, se nuk e shkel vetura njeriun, por njeriu veturën. E kemi një ministër që e punëson kënd të dojë dhe askujt nuk i tutet sepse është apo ka prejardhje nga Faraoni i Egjiptit, Tuta - kak - mon. Për sukseset dhe ministrat dhe ministreshat (konteshat) tjerë/a, një herë tjetër.

Goran Rakiq është udhëheqës i një Liste, jo Guxo, por i Listës Serbe, e regjistruar në Prishtinë por me mendje, shpirt dhe veprim është e Beogradit. Është pjesë e kabinetit të Qeverisë së Kosovës dhe bën pjesë në ministrat e baustellës. Gjysma e Qeverisë së Kosovës është e tillë, me ministra dhe

ministresha të baustellës. Goran Rakiq është kryegjëja dhe kuptimi i kundërshtimit të shtetit të Kosovës dhe kryebarrakadisti i barrakadave mobile që i vendos Serbia në veriun e Kosovës çdoherë kur ka nevojë që Aleksandër Vuçiq të përjetojë orgazëm nacionaliste dhe shoviniste. Ky haptazi thotë se kryetar e ka Aleksandër Vuçiqin e jo Vojsa Osmanin, se kryeministër nuk e ka zotin Albin Kurti, por zotin Ana Brnabiq dhe se shteti i tij është Serbia dhe jo Kosova. Madje kërcënon se do të dalin nga institucionet e Kosovës, ku marrin paga të pamerituara dhe gëzojnë privilegje që as Vuçiqi nuk ua jep dhe se tokë serbe është çdo pëllëmbë ku shkelin Radoiçiqi, Sava Janjiqi, Delibashiqi, Vulin dhe humanistët e shquar serbë të tjerë. Ishte një reagim që kërkohet nga kryeministri Kurti ta shkarkojë Goran Rakiqin, por se kjo nuk

ndodhi me arsyetim se pas Titos (Rakiqit) vjen Tito (Rakiqi) tjetër! Nuk e luan topi. Në imagjinatën më perfeksioniste që ua kalon edhe amatorëve siç ishin Frojdi, Adleri, Fromi, Niçe, Spinoza dhe të ngjashmëve, Besnik Bislimi, me profesion kontabilist - ekonomist, numri 2 i qeverisë së baustellës dhe kryenegociatori për bisedime me Borellin dhe Lajçakun, si dëgjues i bindur dhe pa dinjitet, si shef i një pjese të mercenarëve të dëshmuar të Ekipit Teknik, pasardhës i denjë dhe i pakontestueshëm i grofit Minhaizen (dëshmon se ka prejardhje fisnike), ka shkuar përtej arsyetimit të kryeministrit Kurti, duke deklaruar se e kanë shumë të qartë se kush është Goran Rakiqi, por se çdo ditë po punojnë për diskreditimin e tij përmes demaskimit që ia bëka Rakiqi vetes, ndonëse Rakiqi po flet pa asnjë maskë dhe pa doreza.

Po të bëheshin bashkë të gjithë psikanalistët e botës dhe Akademia e Psikoanalizës në Vjenë nuk do të hynin aq thellë në çmontimin e një misteri shkencor sikur që është personaliteti i Goran Rakiqit. Kompleksi i Edipit është shkërdhatë krahasuar me Kompleksin e Besnikut! E tash, i gjori Rakiq, pas konstatimit shkencor dhe gjenetik për figurën dhe personalitetin e tij nga autoriteti i Shkollës Psikologjike të Muçiverces, tërë kohën po e kalon në seanca të trajtimit psikologjik dhe psikiatrik. Rruga e Golgotës e Goran Rakiqit nisët nga Beogradi, me bekimin e Pont Pilatit e përfundon në Mitrovicë të Veriut ku e presin legjionarët që do ta kryqëzojnë. Fort shumë po i ha luli Rakiqit për konstatimet shkencore të Besnik Bislimit! Pas përfundimit të bisedimeve, qartë do të dihet se kush do të ketë nevojë për seanca dhe

dhe trajtim psikiatrik. Unë nuk kam asnjë mëdyshje në këtë drejtim.

Trajtimi i rastit të mëparshëm ishte çështje e raportit Prishtinë - Beograd kurse rasti i dytë që do të trajtohet është edhe më i rëndësishëm se ai i pari për faktin se trajton raportet Prishtinë - Tiranë. Bëhet fjalë për refuzimin që ta takojë presidentin e Shqipërisë, Bajram Begajn, presidenti i LDK-së dhe Princi i Malçidezekut, Lartmadhëria e Tij, Mumnir Kapcixhiku. Të gjithë e takuan presidentin e Shqipërisë (opozita) në Kuvendin e Kosovës kurse Kapcixhiku kërkoi që të vizitohet në selinë e Partisë që e drejton, në selinë e Riinvestit. Në të kundërtën, mund ta thyejë qafën përmes Qafës së Morinës e të shkoj nga ka ardhur. LDK-ja e arsyeoi këtë veprim të playboit që, në rrethana të fatkeqësive elementare politike u bë kryetar i kësaj partie kurse, disa anal-istë nga Tirana dhe Prishtina që, nëse i quan idiotë e marrin si ngritje të gradës shkencore, refuzimin e Lumit të Xhikës që ta presë presidentin shqiptar e përkrahin shkak, se, gjithnjë sipas tyre, presidenti Begaj qenka pion i Edvin Kristaq Ramës, "vëlla" i Aleksandër Vuçiqit dhe se udhëheqë politikë kundërshtuar. Çfarë perversiteti idiotesk! Çfarë çrregullimi mendor! Sepse, për ta fituar mëshirën dhe bekimin e pushtetit aktual, mjafton ta sulmoni Edi Ramën se është tradhëtar e që automatikisht i rritë kredencialet patriotike të kryeministrit të Kosovës. Nuk sulmohet Rama se qenka tradhtar, askush, me dy koç.. mend nuk e beson këtë por se e konsiderojnë si kundërshtar -armik të Albin Kurtit! Çfarë perversiteti idiotesk! Po, sipas informatave, edhe presidenti Begaj ka rënë në depresion të thellë dhe po trajtohet nga psikanalistë më në zë të Shqipërisë shkak se Mumnir Kapcixhiku nuk paska pranuar ta presë në Kuvendin e Kosovës. Sigurisht po pret të formohet Zajebnica ku edhe do të realizohet kjo pritje! Nostalgjikët e Jugosllavisë, alfabetin e të shkruarit dhe të menduarit e kanë me shkronja serbe, cirilike. E tillë ishte ftesa e Millos për një takim në një lokal nate të cilën Mumniri e tumniri menjëherë!

Bisedimet në Bruksel dhe pordhët nukleare: I tërë kombi kosovar u mbajt në shtetrrëhim gjatë takimit të dy "gladiatorëve në luftë me dema të tredhur", Albin

Kurtit, kryeminister 51% i Kosovës dhe Aleksandër Vuçiq, president 60% i Serbisë. Kjo ishte fuqia e votave të tyre. Shkas ishte 1 shtatori kur përfundon besa e Eskobarit dhënë Serbisë. Bëheshin parashikime të rënda që ndjellnin kob prandaj, thuaja dhunshëm u sollën në Bruksel, kryeministri Kurti për takim me anëtarët tjerë të delegacionit të Serbisë në krye të cilit ishte Vuçiq, Mirosllav Lajçak dhe Josef Borrell. Mediat raportonin nga takimi për një disponim mortar ku, Vuçiqi, vajtues dhe "luftëtar për paqe", në një rënë anë bënte edhe të pamunduren që të arrihet kompromisi kurse Kurti, në anën tjetër refuzonte çdo propozim, pavarësisht se nga vinte! Kjo mjaftoi që të [ndizet idolatria e besnikëve të kryeministrit të cilët, edhe kësaj radhe shfrytëzuan rastin të sulmojnë heronjtë e vërtetë të luftës dhe të lirisë së Kosovës që po mbahen peng në Hagë nga një Gjykatë puro raciste. Çfarë kompromisi po ofron Vuçiqi, ky mashtrues që me lotët e një plake të përnuajtur e luan rolin e viktimës duke dribluar, së paku deri më tani të gjithë lehtësuesit e dialogut dhe qendrat e vendosjes. Vuçiqi nuk po bënë kurrfarë kompromisi, po bisedon për arat e Kosovës, për njerëzit e Kosovës, për politiken e Kosovës, për sigurinë e Kosovës dhe për statusin e Kosovës, sikur të ishte kryetar i Kosovës e jo i një shteti, Serbisë që skajshmërisht sillet armiqësisht ndaj vendit tonë! Nëse dikush do të detyrohet të bëjë kompromis ai do të jetë kryeministri Kurti e jo Vuçiq sikur që ishin politikanët kosovarë para Kurtit që u detyruan të bëjnë kompromis. Kurti i ka ra hise të bëjë kompromis, jo dosido por kompromis të dhimshëm! A do ta bëjë? Mendoj se do ta bëjë prandaj janë angazhuar shtetet miqësore dhe "miqësore" duke shtuar presion. Fillimisht e shtyenë deri më 1 shtator zbatimin e reciprocitetit për targa dhe dokumente e, që, ndërkohë do të arrihet një marrëveshje e imponuar, jo për Serbinë por për Kosovën. A do të bisedonin SHBA dhe Meksiko për targa të automjeteve? Kurrë dhe asnjëherë. A do të bisedonin Franca dhe Gjermania për targa Kurrë dhe asnjëherë. Kjo është çështje ekskluzivisht e shteteve sovraane dhe të pavarura. Realisht, për të mbuluar kompromisin që për Serbinë nuk është fare kompromis, u

krijua një atmosferë lufte e cila vetëm sa nuk ka shpërthyer! Pati lëvizje të KFOR-it në veri të Kosovës. Për të na vënë në gjumë dhe për të na ushqyer egon e llaskucërisë dhe të dorëzimit përkatësisht për të na ambalazhuar frikën me një cipë të hollë trimërie, theksuan se në veri të Kosovës po shkojnë ushtarët amerikanë. Në të njëjtën kohë ambasadori Hill po thotë se në Evropë ka asociacione që mund të merren si model edhe për Kosovën duke menduar, besoj në rastin e Tirolit Jugor (Alto Adixhe), Belgjikës Lindore, kantoneve zvicerane apo, për shkak të afërsisë gjeografike edhe kantonet e Bosnjes dhe Hercegovines që, sigurisht do të pranohej nga serbët dhe, pa asnjë dyshim edhe nga "lehtësuesit" Borrell dhe Lajçak, mbase edhe nga ambasadori Hill, me disa përmirësime kozmetike. Do të krijohet një ekuilibrim i kantonizimi serb sipas dëshirës së Vuçiqit; kantoni i Republika Serbska me Dodikun në krye dhe Zajebnica, me Goran Rakiqin, në krye. U shtuan bisedat telefonike dhe selamet e dërguara nga sekretari Blinken, Stoltenberg, kancelari Sholc, Makroni i Frances dhe të tjerët. Nga ana e partisë në pushtet po thuhet se kjo po bëhet për shkak të vendosmërisë së kryeministrit Kurti për të mos lëshuar pe në bisedime me Serbinë. Dhashtë Zoti e të jetë ashtu! Edhe unë do t'i përkrahja, pa asnjë dyshim! Besoj se është e kundërta, lëshimet janë bërë, premtimet janë dhënë dhe duhet të pregatitet opinionin. Për ta lehtësuar këtë, tash Eskobar dhe Lajçak po shtrojnë drekë pune (nënshtrimi apo pajtimi) me krerët e opozitës të cilët si Red Bull-i, duhet ta bëjnë me krahë kryeministrin Kurti. Të gjithë po futen në një vorbull apo kaban, pozitë dhe opozitë për të relativizuar dhe shpërndarë përgjegjësinë eventuale. Këto janë presione konkrete e që do të japin rezultate konkrete. Kërcënimet për eskalim të situatës, si nga Kurti, ashtu edhe nga Vuçiqi përmes Goran Rakiqit dhe Brigadës së veriut janë pordhë të ftohta që e ngrohin atmosferën në kohë të mungesës së rrymës. As nuk do të ketë luftë e as viktimë, as bllokim të institucioneve si pasojë e largimit të serbëve nga institucionet. Ata që e bënë luftën dhe që përsëri do ta bënin janë ose në Hagë, ose në pritje për Hagë. Këta që i kanë rënë

Santorinit, Mykonos, hoteleve të shtrenjta në SHBA dhe shtetet evropiane, që në vend të kifleve po hanë kavijar dhe fruta deti, që, përveç bakllavasë i kanë rënë edhe të gjitha ëmbëlsirave tjera, nuk do të luftojnë asnjëherë. Mos do të luftojnë ata që nuk e dinë se kur është ditëlindja e Adem Jasharit por llaskucërisht e festojnë ditëlindjen e Bill Klintonit apo ata që thonë se në qiell janë bombahedhësit amerikanë kurse në tokë Baba (Skënderbeu)! Pordhë të ftohta janë këto. Sipas informatave, deri më tani kam besuar se Kosova i ka tre personalitete që thirreshin Baba. Ata janë; Albin Kurti, Enver Hasani dhe Ismet Munishi. Kah doli edhe Baba i katërt; Skënderbeu! Tradicionalisht, ku ka shumë baballarë, fëmijët (shteti) nuk është në rregull!

Tash, darka apo dreka e emisarëve amerikanë dhe evropianë është një përkrahje për Albin Kurtin, një detyrim i opozitës ndaj procesit që, edhe nëse nuk dëshiron të jetë aktive, atëherë të jetë bashkëpunuese. Detyrimisht bashkëpunuese. Se çfarë opozite kanë bërë deri më tani, në planin e brendshëm, as edhe një hamburger nuk e kanë me do të pranojë, ose do rituar. Në fund të fundit, nëse botërisht deklaroheni se pa amerikanët dhe pa Brukselin nuk mund të ketë zgjidhje atëherë, si të kundërshtojmë një propozim edhe në rast se nuk na pëlqen. Albin Kurti nuk është në pozitë të mbrojtjeje parime, nuk ka aspak hapësirë manovruese dhe, ose do të shkojë. Procesi e mbanë në pushtet dhe procesi e largon nga pushteti, kurrsesi opozita. Dhe, mund edhe të gaboj, por, Albin Kurti me asnjë kusht nuk do të largohet nga pushteti sepse e ka ndërtuar një piramidë që është e varur ekzistencialisht nga pushteti. Përfundimisht, Zajebnica nuk është zgjidhje për Kosovën por vetëm sa e ngatërron problemin. Do të mbetet një urë lidhëse midis Kosovës dhe Serbisë, do ta ruaj dhe do ta forcojë ndikimin e Serbisë në Kosovë. Në gjendjen në të cilën jemi, Kosova ka nevojë për një zgjidhje radikale që përfundimisht e ndanë nga Serbia dhe ia pamundëson Serbisë të ndërhyjë në punët e brendshme. Këto vizita që po i bëhen Kosovës, drekat dhe darkat janë presion mbi Kosovën dhe imponim të një zgjidhjeje e cila nuk është zgjidhje. Albin Kurti e ka më së vështiri kurse Besnik Bislimi do të jetë figura tragjike e këtij procesi kur do


të hapen dhe mbyllen llogaritë.

Zhvillimet shqiptare dhe kushtimisht shqiptare:

Dritan Abazoviqi iku përlesh. Erdhi në pushtet me mashtrime dhe improvizime me qëllim të vetëm ta burgosë Babain e shtetësisë së Malit të Zi, Milo Gjukanoviç. U lidhë me popat e Beogradit duke bërë përpjekje që Malin e Zi ta vënë nën tapi të Kishës Ortodokse të Serbisë. Milo Gjukanoviç e bëri kryeministër të Malit të Zi dhe po ky Milo ia tregoi derën. Kur u bë kryeminister i Malit të Zi asnjëherë nuk e përmendi se është shqiptar, kur e shkarkuan tha se po e bëjnë shkak se qenka shqiptar, jo se ka nënshkruar pronësinë e Malit të Zi kishës Ortodokse serbe. Dyfytirësh dhe manipulant. Nuk meritoi fund më të mirë!

Zijadin Sela dha dorëheqje nga kryetari i Alternativës Shqiptare. Ai nuk e luiftoi shovinizmin maqedonas por e luftonte Ali Ahmetin. Ai asnjëherë nuk u bë lider i vërtetë sepse u shndërrua në tullumbace të Vetëvendosjes. Nuk kishte leadership për faktin se rolin e liderit përpiqej ta ndërtonte përmes viktimizimit pasi e rrahën në Kuvendin e Maqedonisë e jo në bazë të rezultateve që duhej t'i kishte por nuk i pati. Mbeti pa asnjë asambleist në Tetovë, kryeqytetin e shqiptarëve në Maqedoni të Veriut. Zijadin Sela nuk ka përmbajtje për t'u bërë lider i vërtetë. Dhe, fundi nuk është i keq për te, ka mundur të jetë edhe më i keq. Kjo dëshmon se përçarja dhe grindavecaria nuk sigurojnë vota e as elektorat afatgjatë dhe stabil. Mësim për disa liderë edhe në Kosovë, të fortë në paraqitje, qyqarë në përmbajtje!

Një lajm i mirë: Gënjit Shala, djali i vetëm i heroit të kombit, humanistit, aktivistit për të drejtat e njeriut, ish-të burgosurit politik, mjekut të popullit dhe mjekut të UÇK-së, vëllaut të pesë motrave, Hafir Shala u martua e që gëzoi shumë Nënë e vet Sakrifikuese, pesë motrat, familjen, miqtë dhe shokët e DOKTORIT, tash i zhdukur nga shteti i Serbisë, u martua me znj. Fjolla. Rast i veçantë dhe i gëzimit për shokë të idealit, shokë të burgut dhe shokë të luftës të DOKTORIT Hafir Shala, Elmiu, dr. Hakiu, Nuhiu, Avdullahu, Idrizi dhe Behxheti që ishin të nderuar që ishin në dasmë, të respektuar nga familja e DOKTORIT dhe nga Gënjit. Po ringritet edhe një trashigimi kombëtar e një Patrioti të Madh si ishte Dr. Hafir Shala.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi punësohen me gradën e kolonelit në Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë

TI RANË, 25 GUSHT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije se kampionët ndërkombëtarë shqiptarë, përfshirë edhe atletet nga Kosova, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi, janë punësuar nga Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, me gradën e kolonelit. "Bazuar në një tjetër vendim qeverie të disa viteve më parë, 'Për kriteret, mënyrën e shpërblyerit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë', janë punësuar atletja Luiza Gega, peshëngritësi Briken Calja, xhudistet Nora Gjakova, dhe Distria Krasniqi, xhudisti Indrit

Çullaj, atleti Ilir Këllezi dhe peshëngritësi Ilirian Suli", ka shkruar Rama në "Facebook". "Ministria e Mbrojtjes ka propozuar disa kohë më parë ndryshime ligjore, të cilat do të mundësojnë përfshirjen e kampionëve ndërkombëtarë në rangun e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe krijimin e një strukture speciale, ku ata do të angazhohen si mentorë të ushtarëve tanë, me pagën sipas gradës, në shërbim të atdheut deri në daljen e tyre në pension. Këto ndryshime i shërbejnë lartësimit afatgjatë të shembullit të kampionëve kuqezinj në promovimin dhe

lartësimin e emrit të vendit tonë në arenën ndërkombëtare. Ligji është në fazën e bashkërendimit me institucionet e linjës, pasi është përmblytur konsultimi publik dhe në mes të shtatorit do të hyjë në procedurën parlamentare".

Sportistët e punësuar aktualisht pranë Ministrisë së Mbrojtjes që do të përfitojnë nga ky ligj me gradën e kolonelit janë:

1. Luiza Gega - "Kolonel"
2. Briken Calja - "Kolonel"
3. Nora Gjakova - "Kolonel"
4. Distria Krasniqi - "Kolonel"



Prishtina me synime të mëdha në Kosovë dhe arenën ndërkombëtare

Prishtinë, 25 gusht - "Bardhekaltrit" i kaluan disa sezone dëshpëruese, ndërsa tash duan të kthehen në majat e basketbollit vendor, por të tregohen të suksesshëm edhe në garat evropiane. Presidenti Burim Maraj, trajneri Ekrem Memnun dhe basketbollisti Dardan Berisha i kanë shpalosur objektivat madhore të prishtinasve në edicionin që do të nisë pas pak javësh. Ata nuk e kanë fshehur objektivin për ta fituar titullin e kampionit për herë të 14-t për këtë klub. "Besoj se do të jetë një stinor shumë konkurrues dhe interesant. Klubi Prishtina do të marrë pjesë në Superligën e Kosovës dhe synojmë të shpallemi kampionë për herën e 14-t. Të gjitha përgatitjet dhe investimet e duhura janë bërë që klubi të ketë



një sezon triumfues. Sigal Prishtina këtë vit merr pjesë në ligën prestigjioze evropiane FIBA Europa Cup, ku skuadra jonë është e vendosur në raundin e dytë dhe po presim fituesin e ndeshjes Bc Kalev Kramon nga Estonia dhe Cd Vita Junior nga Kroacia. Ndeshja do të zhvillohet

më 27 dhe 30 shtator. Po këtë vit klubi ynë, për shkak të imazhit të mirë ndërkombëtar që vjen nga sukseset e mëparshme, është i ftuar edhe në ligën EN BL, European North basketboll ligë, apo liga e Evropës Veriore. Në këtë ligë përfshihen skuadra të forta evropiane me shtetet superfuqi të

basketbollit", ka deklaruar presidenti Maraj në konferencë për medie. Trajneri Memnun do ta nisë përvojën e dytë të "bardhekaltrit" kurse, sipas tij, kryeqytetasit e dinë tashmë se si fitohen trofetë. "Siç e tha edhe presidenti, unë e di ku jemi, i di pritjet, e di çfarë është Prishtina kështu që ne jemi këtu për ta sjellë Prishtinën dhe t'i bëjmë 'Plisat' të lumtur ku ne ishim. Prishtina duhet të fitojë trofe. Ata e dinë se si fitohen trofetë dhe pritjet për trofe. Ne, gjithashtu, i njohim kundërshtarët, i respektojmë të gjithë dhe qëllimi ynë i parë është natyrisht që të provojmë të kualifikohemi në fazën e grupeve të FIBA Cup që do të jetë objektivi ynë i parë", është shprehur trajneri turk. Optimizëm për suksese vendore

dhe ndërkombëtare u shpreh edhe basketbollisti i kthyer në Prishtinë, Dardan Berisha. "Kam ardhur për të fituar, kam ardhur për t'i fituar të gjitha çfarë është e mundshme. Jam shumë i motivuar. E di çfarë kërkon Prishtina. Besoj në trajnerin, në të gjithë stafin. Po besoj se do t'i arrij qëllimet... Jo vetëm me Pejën, por të gjitha ndeshjet do të jenë të vështira. Të gjitha ekipet janë forcur, por normalisht që me Pejën është derbi. Unë jam shumë i motivuar. Do të jetë një vit shumë i vështirë për ne, por po besoj se do ta kalojmë dhe të kemi sukses", ka deklaruar Berisha. Sigal Prishtina pritet ta thotë fjalën kryesore në basketbollin e Kosovës në edicionin e ri, edhe pse skuadrat e tjera janë po aq të fuqishme sa kryeqytetasit.

Përfaqësueset e Kosovës përgatiten në Brezovicë



PRISHTINË, 25 GUSHT - Boksierët dhe boksieret e përfaqësueses së Kosovës të të gjitha grupmoshave udhëtuan për përgatitjet bazike në Brezovicë. Federata e Boksit e Kosovës vazhdon sipas planprogramit të paraparë për

përgatitje bazike të boksierëve të Kosovës para fillimit të garave kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto përgatitje janë të mirëseardhura për boksierët dhe boksieret seniorë dhe të rinj para garave ndërkombëtare që i presin

në muajt në vijim: Kampionati Ballkanik në Sofje, turneu ndërkombëtar "Balkan" në Monza, kampionati evropian në Glivice, turneu i 17 ndërkombëtar "Silesian" për Sarajevë, turneu ndërkombëtar

"Mustafa Hajrulahoviq Talijan" në Budva, kampionati evropian në Pragë, turneu ndërkombëtar "Julius Torma Memorial" në Prishtinë, turneu ndërkombëtar "Adem Jashari" dhe kampionati botëror në Spanjë.

Ademi takohet me Figon, e fton për vizitë në Kosovë

PRISHTINË, 25 GUSHT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, është takuar me legjendën e futbollit portugez dhe botëror, Luis Figo, i cili është këshilltar i UEFA-s. Ademi e njoftoi Figon për zhvillimin dhe rritjen e

vazhdueshme të futbollit kosovar pas anëtarësimit në UEFA e FIFA. Gjithashtu, e njoftoi legjendën portugeze edhe për suksesin e Ballkanit në Ligën e Konferencës. "Figon e ftova për vizitë në Kosovë, ftesë të cilën ai e pranoi me kënaqësi.

Këshillat e tij për futbollin, ajo çfarë ka mësuar ai gjatë karrierës së tij tejet të suksesshme dhe vizioni për të ardhmen, janë të mirëseardhura jo vetëm për UEFA-n, por edhe për ne si federata kombëtare", ka thënë Ademi.



Ricciardo largohet në fund të sezonit nga McLaren

PERTH, 25 GUSHT - Piloti australian Daniel Ricciardo do të largohet nga McLaren në fund të këtij sezoni. Lajmin e konfirmoi makina britanike, duke bërë me dije se palët do të ndahen pas dy vjetësh bashkëpunim, ku Ricciardo nuk

u ngjit asnjëherë në lartësinë që pritej. Australiani kishte edhe një vit kontratë me McLarenin, por palët e kanë zgjidhur atë në mënyrë konsensuale. Me McLaren, Ricciardo arriti vetëm një fitore, sezonin e kaluar në Formula 1, në pistën e Monzas.

“Së shpejti do ta konfirmojmë pilotin e ri për vitin 2023”, ka njoftuar makina britanike. Daniel Ricciardo, 33 vjeç, numëron 223 gara në Formula 1, një nga veteranët e këtij sporti. Ai ka fituar 8 gara dhe është ngjitur në podium në 32

gara. “Për mua ishte privilegj të garoja me këtë makinë. Ende nuk e kam vendosur se cila do të jetë e ardhmja ime. Besoj se së shpejti do të marr një vendim, nëse do të vijoj të garoj në Formula 1 apo jo”, u shpreh Daniel Ricciardo.



Casemiro: Unitedi është klubi më i madh në Angli

MANCHESTER, 25 GUSHT - Casemiro ka dhënë intervistën e tij të parë pas transferimit nga Real Madridi te Manchester Unitedi. Braziliani e ka marrë lejen e punës, e cila ekziston si procedurë në Britaninë e Madhe dhe tashmë do të mund të stërvitet me shokët e skuadrës dhe të jetë në dispozicion të Erik ten Haag për ndeshjen kundër Southamptonit. “Këtu u ktheva pas 15 vjetësh. Shumë njerëz nuk e dinë që kam luajtur këtu kur isha 15 vjeç sa isha lojtar i Sao Paulos. Kur luajta në atë turne, doja të vij tek Unitedi. Dhe tani që jam sërish këtu, jam njeriu më i lumtur në botë dhe mezi pres të luaj për ta ndihmuar Unitedin të fitojë trofe”, ka thënë Casemiro.

Më pas ai u pyet se si reagoi kur dëgjoi për herë të parë për interesimin e Unitedit. “Epo, është klubi më i madh në Angli, me shumë tituj. Jam i lumtur dhe mezi pres të filloj të luaj”, ka deklaruar braziliani, i cili theksoi me pas se ëndrra e tij ishte të luante në



Premierë Ligë. “Gruaja ime flet anglisht. Unë kam një vajzë shtatë vjeçe dhe një djalë një vjeç. Ata flasin anglisht pak më mirë se unë. Më vjen keq që nuk flas anglisht me ju dhe fansat, por dua të mësoj”, ka shtuar Casemiro. Sipas

“Transfermarkt”, Casemiro iu bashkua “Djajtë e Kuq” për 70 milionë euro. Ai nënshkroi një kontratë katërvjeçare me opsion për ta vazhduar atë edhe për një vit. Ai deri tani ka luajtur 63 ndeshje me kombëtaren braziliane.

Verë e nxehtë në ishull, njihuni me transferimet më të bujshme në Premierë Ligë

LONDËR, 25 GUSHT - Premierë Liga mbetet kampionati më i fortë në Evropë, i shumë dëshiruar nga yjet e futbollit botëror. Ky trend nuk ndryshoi as në këtë merkato vere ku transferimet më të bujshme erdhën pikërisht nga ishulli britanik. Më 75 milionë euro, Darwin Nunez rezultoi lëvizja më e shtrenjtë në këtë merkato, një operacion i vënë në jetë nga Liverpooli. Në vendin e dytë renditet blerja e fundit e Man. Unitedit, Casemiro, një transferim që u kushtoi “djajve të kuq” 70,65 milionë euro. Podiumin e lojtarit më të shtrenjtë pritet ta marrë Isak me Newcastle që do të derdhë në arkat e Real Sociedadit 70 milionë euro. Ndryshe nga se ishte perceptuar në fillim Erling Haaland nuk është blerja më e shtrenjtë, por sërish Manchester City pagoi 60 milionë euro për ta



marrë nga Borussia Dortmundi. Norvegjezi renditet në vendin e pestë pasi përpara tij pozicionet Cucurella i Chelsea me 65,30 milionë euro. Në këtë listë me

blerje të bujshme gjejmë edhe emra si Richarlison që u transferua te Tottenham për 58 milionë euro, Lisandro Martinez, Sterling e shumë të tjerë.

SHKURT

Kumbulla mund t'i bashkohet Interit

Skuadra e Interit i rikthehet pistës Marash Kumbulla dhe, së fundmi, ka një skenar që mbrojtësi të transferohet nga Roma në Milano. Mediet përtej Adriatikut raportojnë se tek Interi mendojnë të japin në këmbim mesfushorin Roberto Gagliardini për shërbimet e Kumbullës. Jose Mourinho kërkon një mesfushor qendre në skuadrën e tij pas dëmtimit të Wijnaldumit dhe Gagliardini mund të jetë një opsion. Për momentin gjithçka është në kuadrin e fjalëve. Kumbulla edhe në të shkuarën është tentuar të merret nga Interi, kur mbrojtësi spikati te Verona.

Umtiti huazohet te Lecce

Mbrojtësi Samuel Umtiti është larguar nga skuadra e Barcelonës. Qendërmbrojtësi francez është huazuar në Serinë A dhe do të jetë shok skuadre me Kastriot Dermakun. Klubi katalanas ka dalë me njoftim dhe bën me dije se francezi do të jetë pjesë e Lecces deri më 30 qershor 2023. Për italianët ky është një përforsim me vlera, ndërkohë që Umtiti do ta ketë mundësinë të luajë dhe të rivlerësohet në treg sërish.

Milik përforcon Juventusin

Sulmuesi polak Arkadiusz Milik i është bashkuar Juventusit në formë huazimi nga Olympique Marseille. “Zonja e Vjetër” do t'i paguajë 2 milionë euro tash, plus 8 të tjerë nëse e blen vitin tjetër. Përfaqësuesi polak e njih mjaft mirë kampionatin italian pasi në të kaluarën kishte luajtur me sukses për gjashtë vjet në Napoli.

Kerber tërhiqet nga ‘US Open’, shkak shtatzënia

Tenistja gjermane Angelique Kerber, ish-numri 1 në botë për femra, ka konfirmuar tërheqjen e saj nga grand slam i “US Open”, që nis më 29 gusht në Nju-Jork. Fituesja e këtij turneu në vitin 2016 ka lajmëruar në rrjetet sociale se është shtatzënë. “Doja të luaja në ‘US Open’, por në fund vendosa që të luaj 2 kundër 1 nuk është e ndershme”, u shpreh duke qeshur tenistja 34-vjeçare. Ajo ka vendosur të rikthehet në vendlindje, ku do ta qëndrojë pjesën e mbetur të shtatzënisë. Gjithsesi, kjo tërheqje e gjatë, që mund të zgjasë më shumë se një vit, nuk do të sjellë një largim të tenistes nga sporti. Ajo synon të rikthehet në fushë. “‘US Open’ ka një vend special në zemrën time, ndaj dua të jem në fushë për t’ju përshëndetur”, ka shtuar Kerber. Sipas medieve gjermane, Angelique Kerber pritet të rikthehet në fushë në gjysmën e dytë të vitit 2023, për ta synuar pjesëmarrjen në Lojërat Olimpikë “Paris 2024”.

Unitedi, pas Casmiros e dëshiron Asension

Manchester Unitedi është përqendruar të përforcohet vetëm nga skuadra e Real Madridit. Pasi transferoi

Casemiron, Unitedi është e interesuar edhe për sulmuesin anësor Marco Asensio. Sulmuesi është lënë jashtë planeve për

sezonin e ardhshëm nga ana e Realit pas bllokimit të negociatave për rinovimin e kontratës, me anglezët që kanë bërë ditën një

ofertë prej 30 milionë eurosh në drejtim të lojtarit. Madrilenët kërkojnë 50 milionë euro për kartonin e 26-vjeçarit, por situata

e tij aktuale në skuadër mund të ndikojë në uljen e çmimit dhe gjetjen e akordit për mbylljen e kësaj manëveshjeje.



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

K O N K U R S **Për plotësimin e vendit të punës**

Titulli: Punëtor Specialist i Grupit të Ashensorëve - 2 (dy) pozitë

Nr. i referencës: NPB/DMI/ 08.8

I raporton: Mbikëqyrësit të njësisë së mirëmbajtjes së rregullt

Niveli i pagës: 715 € bruto

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të pacaktuar (puna provuese deri në 3 muaj)

Vendi i punës: Rr."Zija Shemsiu" nr.22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

Detyrat e përgjithshme:

- Është përgjegjës për realizimin e objektivave të caktuara nga mbikëqyrësi i njësisë;
- Ndihmon mbikëqyrësin e njësisë bashkë me kryepunëtorët e tjerë në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave për Departamentin Mirëmbajtjes dhe Investimeve;
- Koordinon punët në mes grupeve së bashku me mbikëqyrësin e njësisë në lidhje me kërkesat dhe nevojat për realizimin e aktiviteteve të nevojshme që kanë të bëjnë me DMI-në;
- Të ketë etikë dhe integritet në punë;
- Merr pjesë në mbledhjet e rregullta ku është i thirrur për nevojat e DMI-së apo të NPB-së.

Detyrat Specifike:

- Është përgjegjës për punët që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e ashensorit;
- Zbaton detyrat dhe aktivitetet operative të përcaktuara nga Mbikëqyrësi i njësisë si dhe koordinon punët që lidhen me mirëmbajtjen e ashensorëve ku NPB ka marrëveshje për mirëmbajtjen e ashensorëve ekzistues, riparimin e ashensorëve si dhe vënien në funksion të ashensorëve të ri;
- Përgatit dhe vendos në funksion ashensorët që janë jashtë funksionit si dhe për çdo intervenim plotëson të dhënat në formën e NPB-së rreth mos funksionimit të ashensorit dhe vendos shënimet në raport për pjesët e vendosura gjatë riparimit të ashensorëve;
- Kryen montimin e ashensorëve të ri, eliminimin e defekteve dhe gabimeve, modernizimin e ashensorëve, shërbime të urgjencës në konsultime me kolegët;
- Është përgjegjës për punët e Departamentit të Mirëmbajtjes dhe Investimeve në mirëmbajtjen e ashensorëve;
- Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të NPB-së;
- Është përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve të punës;
- Është përgjegjës për ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë për veten e tij dhe për punonjësit e tjerë me të cilët punon;
- Raporton për punët e kryera te udhëheqësi i njësisë;
- Përgatit raportet e punës në baza ditore, javore, mujore, vjetore për punën që është ngarkuar.

Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:

- Mbikëqyrësi i njësisë mund ta ngarkojë me detyra të tjera sipas nevojave të NPB-së;
- Ne rast mungese të punonjësve tjerë, me urdhër të mbikëqyrësit mund ta zëvendësojë dhe të kryej detyra tjera;
- Kryen edhe detyra tjera që ndërliken me përshkrimin e detyrave të punës, si dhe detyrave të ngarkuara nga menaxhmenti.

Kualifikimet:

- Diplomë e shkolles së mesme;
- Patent shofer kategoria-B;

Aftësitë:

- Njohuri ideale në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të ashensorëve;
- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;
- Njohje të shkëlqyer të materialeve dhe mjeteve të punës që kanë të bëjnë me ashensorë;
- Të ketë kujdes të shtuar dhe të respektojë normat për sigurinë në punë;
- Të jetë i gatshëm të punojë natën dhe fundjavave;
- Duhet të jetë në gjendje të lexojë, kuptojë manualët që kanë të bëjnë me ashensorë;
- Të jetë i gatshëm të punojë në objekte me lartësi të madhe;
- Të jetë në gjendje të bëjë paramasat dhe parallogaritë që kanë të bëjnë me ashensorë;
- Të jetë i gatshëm të punojë në të gjitha kushtet atmosferike;
- Të jetë i gatshëm të qëndrojë në këmbë për periudha të gjata kohore;
- Aftësi të punojë në ekip, të ketë vetëiniciativë dhe qasje konstruktive;
- Shkathësi të shkëlqyer komunikative, organizative dhe analitike;
- Etikë në punë dhe integritet të lartë;
- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;

Kualifikimet e preferueshme:

- Kurset dhe trajnimet tjera gjatë karrierës profesionale;
- Çertifikatë mbi njohuritë e avancuara si mjeshër i ashensorëve.

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë të Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes

Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faja e internetit në adresën: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesi-punesimi/. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Prishtinë, ose të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedurë të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPB-së;
- CV/Resume;
- Dëshmitë për Shkollën e Mesme;
- Patent shofer kategoria-B;
- Dëshmitë për përvojën e punës për pozitën e kërkuar së paku 2 vite;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet të sjellë certifikatën mjekësore para nënshkrimit të kontratës.

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIONIT, NUK DO TË SHOYRTOHEN.

Shpallja është e hapur që nga data 24.08.2022 deri më 07.09.2022

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Ekotek 3" SH.P.K. me pronar Valon Salihu Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811566811 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Ekotek 3" D.O.O. Valon Salihu Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811566811 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Ekotek 3" L.L.C. Valon Salihu Gnjilan, has come to the decision to quit its business: 811566811 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



NDËRMARRJA
PUBLIKE
BANESORE

Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendit të punës

Titulli: Zyrtar/e për faturim dhe të hyra/ Inkasant/e - 1 (një) pozitë

Nr. i referencës: NPB/DSHK/ 10.8

I raporton: Udhëheqësit të Divizionit për menaxhim të llogarive dhe kontratave

Niveli i pagës: 6

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Për periudhë të caktuar 1 vjeçare (puna provuese deri në 3 muaj)

Vendi i punës: Rr."Zija Shemsiu" nr.22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të kenë cilësi të menaxhimit me letra me vlerë, faturave, të hollave dhe besueshmëri;
- Cilësi të komunikimit me konsumatorë;
- Aftësi të marrjes së përgjegjësiave materiale dhe penale;
- Të identifikojë konsumatorët e ri, të përcjell gjendjen e konsumatorëve ekzistues, të ngarkohet me fatura, të inkasojë, të dorëzojë pazarin ditor çdo ditë;
- Të mbaj shënime për secilin konsumatorë sa i përket kërkesave, ankesave dhe sugjerimeve dhe t'i delegojë ato për shqyrtim;
- Të menaxhoj vonesat në pagesa së bashku me Udhëheqësin e Divizionit për Menaxhim të Llogarive;
- Të realizojë normën e inkasimit sipas akteve normative në fuqi të ndërmarrjes;
- Të kryejë telefonatat mujore dhe procedurat e tjera që ndihmojnë procesin e inkasimit të borxheve.

Detyrat dhe obligimet tjera

shtesë:

- Udhëheqësi i Divizionit për Menaxhim të Llogarive e ngarkon me detyra tjera sipas nevojës së NPB-së;
- Në rast të mungesës së zyrtarëve tjerë me urdhër të menaxhmentit mund ta zëvendësojë dhe të kryej detyrat tjera.

Kualifikimet:

- Diplomë e shkolles se mesme;
- Dëshmi për përvojë pune së paku 1 vit.

Aftësitë:

- Aftësi kompjuterike në gjithë aplikacionet e MC Office;
- Shkathtësi të mira komunikimi dhe negociuese;
- Aftësi të larta të evidentimit dhe sistemimit të dokumentacionit;
- Në gjendje për të punuar nën presion dhe me orar të zgjatur;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Njohja e gjuhës Angleze;
- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
- Shkathtësi të shkëlqyera komunikative, organizative dhe analitike;
- Etikë në punë dhe integritet të lartë;
- Shkathtësi për të punuar në grup dhe të dëshmoj fleksibilitet në punë;

Kualifikimet e preferueshme:

- Kurset dhe trajnimet tjera gjate karrierës profesionale;
- Patent shofer kategoria-B.

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes

Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesi-punesimi/ . Dokumentacionin mund ta

paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Prishtinë, ose të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPB-së;
- Dëshmitë për Shkollën e Mesme;
- Dëshmitë për përvojën e punës së paku 1 vite;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet të sjellë certifikatën mjekësore para nënshkrimit të kontratës.

**APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR
SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI
DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË
KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.**

Shpallja është e hapur që nga data 24.08.2022 deri më 07.09.2022

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Ylli Company” SH.P.K. me pronar Daut Gjokaj Tërstenik, Glllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811167817 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ylli Company” D.O.O. Daut Gjokaj Tërstenik, Glllogoc, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811167817 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Ylli Company” L.L.C. Daut Gjokaj, Tërstenik, Glllogoc, has come to the decision to quit its business: 811167817 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NDËRMARRJA
PUBLIKE
BANESORE**Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendit të punës**Titulli: Zyrtar/e për menaxhimin e kërkesave dhe ankesave - 2 (dy) pozitë****Nr. i referencës: NPB/DSHK/ 10.4****I raporton: Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime të Përgjithshme****Niveli i pagës: 6****Orët e Punës: 40 orë në javë****Kohëzgjatja e kontratës:** Për periudhë të caktuar 1 vjeçare (puna provuese deri në 3 muaj)**Vendi i punës:** Rr."Zija Shemsiu" nr.22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Është përgjegjës për trajtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve që kanë të bëjnë me NPB-në;
- Kërkesat dhe ankesat i delegon tek ekipet përkatëse në terren;
- Koordinon rrjedhjen e punëve për ankesat dhe kërkesat deri tek feedback-u tek konsumatorët;
- Mban evidencën për punët që është i/e ngarkuar;
- Bën inspektimin e cilësisë së shërbimit të mirëmbajtjes dhe shërbimeve të tjera të ofruar nga NPB-ja;
- Mban kontakt të rregullt me qytetarë dhe grupe të tjera siç janë përfaqësuesit e hyrjeve;
- Kryen të gjitha punët e nevojshme në pikat kontaktues në lagjet e qytetit;
- Koordinon punët ndërmjet Qendrës së Thirrjes dhe ekipeve të mirëmbajtjes në terren;
- Përgatit materialin logjistik të nevojshëm për punët e Divizionit për Shërbime të Përgjithshme dhe të Departamentit të DKM-së në përgjithësi;
- Përgatit Raportet për punët e kryera në terren dhe në pikat kontaktuese.

Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:

- Udhëheqësi i Divizionit/Zyrës për Shërbime të Përgjithshme e ngarkon me detyra tjera sipas nevojës së NPB-së;
- Në rast të mungesës së zyrtarëve të tjerë me urdhër të menaxhmentit mund ta zëvendësojë dhe të kryej detyra tjera.

Kualifikimet:

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Dëshmi për përvojë pune së paku 1 vit.

Aftësitë:

- Aftësi kompjuterike në gjithë aplikacionet e MC Office;
- Shkathtësi të mira komunikimi dhe negociuese;
- Aftësi të larta të evidentimit dhe sistemimit të dokumentacionit;
- Njohja e gjuhës Angleze;
- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
- Në gjendje për të punuar me orar të zgjatur;
- Shkathtësi të shkëlqyera komunikative, organizative dhe analitike;
- Etikë në punë dhe integritet të lartë;
- Shkathtësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë.

Kualifikimet e preferueshme:

- Kurset dhe trajnimet tjera gjatë karrierës profesionale;
- Patent shofer kategoria-B.

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes

Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesi-punesimi/. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Prishtinë, ose të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.**Dokumentet që duhet të bashkangjiten:**

- Aplikacioni i NPB-së;
- Dëshmitë për Shkollen e Mesme;
- Dëshmitë për përvojën e punës së paku 1 vite;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet të sjellë certifikatën mjekësore para nënshkrimit të kontratës.**APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURISIT, NUK DO TË SHOYRTOHEN.****Shpallja është e hapur që nga data 24.08.2022 deri më 07.09.2022****Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.****>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Granit Bërbatovci shpalltë pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Hysen Sylmeta nga Gërçin KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "7 Shtatori" Gërçin KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qerane Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Drilon Balijs nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Halil Gjoshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Elektro-Repart.

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Rifat Berberi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Q.M.N "Hajdar Dushi".

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

